



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:226363
Datë: 16.09.2024
Numri i dokumentit: 06166725

C-IV-14-4591

Paditësi

H K nga Suhareka, përfaqësuar nga av. R G, Suharekë

kundër

E paditura

Agjencia Kosovare e Privatizimit për NSH ‘IGK Ballkan’ (në likuidim), Rr. ‘Dritan Hoxha’, Nr. 55, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Diellza Hoxha, me 16 shtator 2024, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

- 1. Padia e paditësit konsiderohet e tërhequr.**
- 2. Paditësi i bartë shpenzimet gjyqësore.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 13 qershor 2014, paditësi parashtrij padi kundër të paditurës N.SH. IGK “Ballkan” përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, për pagesën e të ardhurave të garantuara dhe njohjen e stazhit të punës.

Me 15 korrik 2024, gjykata lëshoj për paditësin urdhër për ta paguar taksën gjyqësore, duke e njoftuar paditësin se nëse taksat nuk paguhen brenda periudhës së caktuar prej 15 ditësh, padia do të konsiderohet e tërhequr.

Arsyetimi ligjor

Padia e paditësit konsiderohet e tërhequr.

Neni 76.3 i Ligjit Nr.06-L-086 Për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës parasheh:

Në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore.

Paditësi konform dispozitës së nenit 253.4 të LPK-së ka për detyrë që padisë t’ia bashkëngjis vërtetimin mbi taksën gjyqësore të paguar.

Ne vazhdim dispozita 253.5 parasheh:

Në qoftë se paditësi nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar për padinë as pas vërejtjes së dërguar nga gjykata, edhe pse nuk ekzistojnë konditat për lirim nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr.

Me 20 shkurt 2024, Gjykata përmes urdhrit kërkoj nga paditësi, që të bëjë pagesën e taksës gjyqësore, duke e njoftuar se padia e saj do të konsiderohet e tërhequr nëse ai nuk e paguan taksën gjyqësore.

Paditësit i është lejuar afati prej 15 ditësh që ta bëjë pagesën e taksës gjyqësore. Sipas vlerësimit të gjykatës, ky është një afat i mjaftueshëm kohor.

Paditësi ka për obligim ti paguaj taksat gjyqësore. Taksat gjyqësore aplikohen sipas nenit 63 të Ligjit të Dhomës së Posaçme në lidhje me udhëzimin e KGJK-së nr. 01/2017, lidhur me taksat gjyqësore.

Vërejtja ishte pranuar nga paditësi me datë 18 korrik 2024, mirëpo ai nuk u përgjigj brenda afatit të caktuar prej 15 ditësh, e as deri me vendosjen e këtij Aktvendimi.

Nga kjo gjykata konsideron se paditësi nuk ka paguar taksën dhe nuk ka interes për çështjen juridike të tij dhe se në rastin konkret sipas dispozitave ligjore padia konsiderohet e tërhequr.

Shpenzimet gjyqësore

Në pajtim me nenin 62.2 të Ligjit të Dhomës së Posaçme (Ligji nr. 06/L-086), paditësi si palë e pasuksesshme do të mbulojë shpenzimet e veta.

Këshillë juridike

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Padia duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Diellza Hoxha Gjyqtare